



# Takim Konsultues

## “Vlerësimi i Integritetit Institucional të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”

📅 13.11.2024

🕒 09:45 – 11:30

📍 Rogner Hotel, sala e konferencave “Antigonea 1”

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ka kënaqësinë t'ju ftojë në një takim konsultues që do të zhvillohet më 13 nëntor 2024, në Hotel Rogner në sallën “Antigonea 1”. Ky takim do të fokusohet në raportin e monitorimit të integritetit institucional të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Qëllimi kryesor i këtij takimi është të ndahen njohuri praktike mbi monitorimin e pavarur të integritetit dhe të promovojmë një kulturë të fortë integriteti në të gjitha institucionet publike. Monitorimi i jashtëm për zbatimin e planeve të integritetit është kyç për të mbështetur një kornizë qeverisjeje transparente dhe llogaridhënëse.

Raporti i hartuar nga një ekip ekspertësh, ofron një vlerësim të detajuar mbi përmbushjen e kritereve të integritetit, meritokracisë, transparencës dhe llogaridhënies të këtij institucioni. Në këtë takim, ekspertët do të paraqesin vlerësimin sipas Indeksit të Integritetit të Institucioneve Publike, instrumenti i parë metodologjik për monitorimin e integritetit publik nga shoqëria civile.

Monitorimi i integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është thelbësor për të siguruar një sistem shëndetësor të besueshëm dhe efikas. Ai promovon transparencën në proceset vendimmarrëse, duke rritur besimin e publikut në institucionet shëndetësore. Përmes këtij monitorimi, identifikohen praktikatat e mira dhe dobësitë institucionale që mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimeve, duke lejuar që të ndërmerren masa parandaluese dhe përmirësuese. Gjithashtu, ndihmon në vlerësimin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë të autoriteteve, duke kontribuar në përmirësimin e politikave dhe praktikave që lidhen me shëndetin publik.

Pjesëmarrësit do të përfshijnë përfaqësues nga institucione të ndryshme dhe trupa diplomatike në vend, duke përfshirë sekretarë të përgjithshëm të ministrive të linjës, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Departamentin e Administratës Publike, Institutin e Shëndetit Publik, akademinë, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile dhe median. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të japin komente dhe sugjerime të vlefshme për përmirësimin e procesit të monitorimit dhe implementimin e planeve të integritetit.

Gjatë takimit, do të diskutojmë për sfidat e hasura dhe për mënyrat se si aktorët e ndryshëm mund të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve publike në fushën e shëndetësisë, si dhe për mundësitë për krijimin e një platforme të fortë për bashkëpunim dhe shkëmbim idesh.

Ky takim përmbyll një etapë të rëndësishme të projektit "Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike", mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Tiranë.

# Programi

 13.11.2024
 09:45 – 11:30
 Rogner Hotel, sala e konferencave “Antigonea 1”

9:45 – 10:00	<b>Regjistrimi</b>
10:00 – 10:20	Fjalët hyrëse:  Z. Sotiraq Hroni, Drejtor ekzekutiv, IDM  Z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  Z. Erik Iles, Zv/Kryetar i Misionit dhe Shef i Bashkëpunimit për Zhvillim, Ambasada e Suedisë në Tiranë
10:20 – 11:00	<b>Gjetjet e raportit të Monitorimit për Integritetin Institucional të MShMS-së</b>  Znj. Elda Zotaj, Eksperte  Z. Astrit Aliaj, Ekspert  Znj. Eralda Mariani, Koordinatore Integriteti, MShMS
11:00– 11:25	Pyetje dhe përgjigje mes pjesëmarrësve
11:25 – 11:30	Përfundime